*Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/l-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullorës me nr. 002/2024 dhe Udhëzuesit 002/2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001/2023 për Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:*

# VENDIM

*Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.*

I

*Menaxher i kontratës për projektin me titull:* "Furnizimi me Aparat Fotografik dhe Dron për nevojat e Komunës së Mamushës" *me numër të prokurimit:* 626-25-6983-1-3-6 *dhe me nr. të* brendshëm 626-25-008-1-3-6, *emërohet z. Nazmi Morina, ndërsa Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet z. Yahya Sala.*

II

*Pas pranimit të kontratës, menaxheri i kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlere të madhe, të mesme dhe të vogël. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitët para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të ekipi të menaxhimit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik , ekipi i menaxhimit të kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.*

III

*Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës*

*Menaxheri i Projektit/Kontratës do të:*

*a. Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;*

*b. Sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe*
*c. Bëj vlerësimin e përformancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.*

*Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:*

*a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e përformancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;*
*b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;*
*c. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;*
*d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;*
*e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;*
*f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontrtës në sistem të prokurimit elektronik;*
*g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;*
*h. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;*
*i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit te puneve, mallrave dhe sherbimeve*
*j. Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimi; dhe*
*k. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.*
*l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).*

V

*Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:*

*Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimindhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij/saj.*

VI

*Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, duhet t'i përmbahen me përpikëri i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/l-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe rregullave tjera të cilat kan të bëjnë me menaxhimin e kontratës.*

**VII**

*Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në ekzekutim të kontratës apo marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.*

*Me këtë vendim të njoftohet:*

- *Drejtoria e Administratës,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Pala,*
- *Arkivit.*

*Abdülhadi Krasniç*
*Kryetari i Komunës së Mamushës*

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 02
Tarih/Dt. 10-09-2025

02 Nr. 174/25
Me 10.09.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligji nr. 08/l-196 Për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme- Agjencia e Menaxhimit Emergjent me numër të protokollit 109 e datës 17.07.2025, neni 82 Statutit të Komunës së Mamushës 0001/2008 e datës 01.12.2008.

**V E N D I M**
**Për ndryshimin në Listë të Pagave**

**Neni 1**

Z. Rahman Morina, nga Komuna e Mamushës, i punësuar në njësinë e zjarrfikësve, në bazë të vendimit të marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia e Menaxhimit Emergjent, me numër protokolli 109, datë 17.07.2025, sipas pikës 3 të këtij vendimi, emërohet në pozitën **Ushtrues detyre – Udhëheqës Skuadre** në Njësinë e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH) në Komunën e Mamushës.

**Neni 2**

Obligohet **Zyra e Personelit** në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin të përcjellë dokumentacionin tek **Thesari i Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)**, me qëllim të ndryshimit në listë të pagave, sipas vendimit për kategorizim në **koeficientin 6.7, Klasa R9**, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nga blloku kodues përkatës.

**Neni 3**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në ndryshimin ose shfuqizimin e tij nga organi kompetent.

**A R S Y E T I M**

Z. Rahman Morina, i cili ushtron funksionin në njësinë e zjarrfikësve në kuadër të Komunës së Mamushës, në bazë të vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme – Agjencia e Menaxhimit Emergjent, është caktuar në pozitën **Ushtrues detyre – Udhëheqës Skuadre në NJPZSH Mamushë.**

Pozita është kategorizuar me **koeficient 6.7, Klasa R9**, sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, duke reflektuar përgjegjësitë, rëndësinë dhe nivelin e detyrave të përcaktuara për këtë funksion. Ky përcaktim është bërë në pajtim me organin kompetent dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të harmonizimit të pozitës së punës me strukturën organizative dhe rritjen e kapaciteteve

profesionale të njësisë së zjarrfikësve dhe shpëtimit në Komunën e Mamushës, duke garantuar ofrimin më efikas të shërbimeve në këtë sektor jetik për sigurinë e qytetarëve.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

**Kryetari i Komunës së Mamushës**

**Abdülhadi Krasniç**

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 02 174
Tarih/Dt. 10-09-2025

02 Nr. 174/25
Me 10.09.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligji nr. 08/l-196 Për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme- Agjencia e Menaxhimit Emergjent me numër të protokollit 109 e datës 17.07.2025, neni 82 Statutit të Komunës së Mamushës 0001/2008 e datës 01.12.2008.

## V E N D I M
**Për ndryshimin në Listë të Pagave**

### Neni 1

Z. Rahman Morina, nga Komuna e Mamushës, i punësuar në njësinë e zjarrfikësve, në bazë të vendimit të marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia e Menaxhimit Emergjent, me numër protokolli 109, datë 17.07.2025, sipas pikës 3 të këtij vendimi, emërohet në pozitën **Ushtrues detyre – Udhëheqës Skuadre** në Njësinë e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH) në Komunën e Mamushës.

### Neni 2

Obligohet **Zyra e Personelit** në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin të përcjellë dokumentacionin tek **Thesari i Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)**, me qëllim të ndryshimit në listë të pagave, sipas vendimit për kategorizim në **koeficientin 6.7, Klasa R9**, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nga blloku kodues përkatës.

### Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në ndryshimin ose shfuqizimin e tij nga organi kompetent.

## A R S Y E T I M

Z. Rahman Morina, i cili ushtron funksionin në njësinë e zjarrfikësve në kuadër të Komunës së Mamushës, në bazë të vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme – Agjencia e Menaxhimit Emergjent, është caktuar në pozitën **Ushtrues detyre – Udhëheqës Skuadre në NJPZSH Mamushë.**

Pozita është kategorizuar me **koeficient 6.7, Klasa R9**, sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, duke reflektuar përgjegjësitë, rëndësinë dhe nivelin e detyrave të përcaktuara për këtë funksion. Ky përcaktim është bërë në pajtim me organin kompetent dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të harmonizimit të pozitës së punës me strukturën organizative dhe rritjen e kapaciteteve

profesionale të njësisë së zjarrfikësve dhe shpëtimit në Komunën e Mamushës, duke garantuar ofrimin më efikas të shërbimeve në këtë sektor jetik për sigurinë e qytetarëve.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

**Kryetari i Komunës së Mamushës**

**Abdulhadi Krasniç**

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02Nr.170-25
Me 10.09.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligji nr. 08/l-196 Për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme- Agjencia e Menaxhimit Emergjent me numër të protokollit 109 e datës 17.07.2025, neni 82 Statutit të Komunës së Mamushës 0001/2008 e datës 01.12.2008.

# VENDIM

## Për përcaktimin e kategorisë së vendit të punës në bazë vendimit MPB-AME Nr.109/2025 e datës 17.07.2025

### Neni 1

Z. Rahman Morina, Ushtrues detyre Udhëheqës Skuadre në NJPZSH në Mamushë i caktuar me vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme- Agjencia e Menaxhimit Emergjent me numër të protokollit 109 e datës 17.07.2025.

### Neni 2

Në bazë të vendimit të marrë nga Ministrisë së Punëve të Brendshme- Agjencia e Menaxhimit Emergjent me numër të protokollit 109 e datës 17.07.2025, sipas pikës 3 të këtij vendimi është caktuar se pozita e Ushtrues detyre Udhëheqës Skuadre në NJPZSH në Mamushë i takon koeficienti është 6.7 Klasa R9 sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

### Neni 3

**Obligohet** Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listë të pagave në bazë të Vendimit të sipërpërmendur koeficienti është 6.7 Klasa R9 sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

### Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

## ARSYETIM

Z. Rahman Morina, i punësuar në njësinë e zjarrfikësve në kuadër të Komunës së Mamushës, në bazë të vendimit të marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia e Menaxhimit Emergjent, me numër protokolli 109/25, datë 17.07.2025, dhe në pajtim me pikën 3 të këtij vendimi, është caktuar në pozitën **Ushtrues detyre – Udhëheqës Skuadre** në Njësinë e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH) në Mamushë.

Në përputhje me dispozitat e vendimit të lartcekur dhe bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është përcaktuar se kësaj pozite i takon **koeficienti 6.7** dhe klasifikimi në **Klasën R9**, duke reflektuar rëndësinë, përgjegjësitë dhe nivelin e detyrave që mbulon kjo pozitë brenda strukturës organizative.

Ky përcaktim është bërë në pajtim me vendimin e organit kompetent, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi dhe duke siguruar harmonizimin e pozitës së z. Rahman Morina me strukturën organizative të njësisë përkatëse dhe me katalogun e miratuar të vendeve të punës në sektorin publik. Vendimi ka për qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të njësisë së zjarrfikësve, garantimin e funksionalitetit të saj, si dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Prandaj, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:

- Z. Rahman Morina;
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
- Personeli
- arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Abdulhadi Krasniç**

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 169-25
Tarih/D. 09.09.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr.169 -25
Datë 09.09.-25
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 21 Ligji nr. 08/l-197 për Zyrtarët Publik, nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik lidhur me nenin 32 Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, neni 44, 45, 46 të Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative statutit te Komunës së Mamushë, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
# PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR PUSHIM VJETOR

## Neni 1

Refuzohet kërkesa për pushim vjetor e paraqitur nga Gazmend Gashi, i punësuar në pozitën Udhëheqë i Prokurtimit, për periudhën 09.09.2025 deri 30.09.2025, me arsyetimin se për momentin paraqitet nevoja e domosdoshme për praninë e tij/saj në vendin e punës, për shkak të detyrave institucionale që nuk mund të shtyhen.

## Neni 2

Ditët e kërkuara për pushim vjetor do të kompensohen në muajin vijues (Tetor).

## Neni 3

Refuzimi i pushimit vjetor do të evidentohen në dosjen personale të zyrtarit publik, sipas procedurave të përcaktuara.

## Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Kërkesa për pushim vjetor refuzohet për arsye të natyrës së detyrave të punonjësit në fushën e prokurimit, të cilat kërkojnë përkujdesje të vazhdueshme dhe përmbushje të afateve ligjore dhe kontraktuale. Gjatë periudhës së kërkuar janë planifikuar procedura të rëndësishme prokurimi, përfshirë shpallje, vlerësime dhe nënshkrime kontraktuale, të cilat nuk mund të shtyhen.

Mungesa e punonjësit gjatë kësaj periudhe mund të ndikonte drejtpërdrejt në vonesa të procedurave dhe pengesa në zbatimin e detyrimeve ligjore të institucionit. Refuzimi i kërkesës është i domosdoshëm për të garantuar funksionimin e pandërprerë të institucioneve dhe respektimin e procedurave të prokurimit.

Ditët e kërkuara për pushim do të mund të planifikohen dhe realizohen në muajin e ardhshëm (tetor), duke respektuar të drejtat e punonjësit dhe nevojat institucionale.

Njoftohet:

- z. Gazmend Gashi
- NjMBNj
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Izlazna - Outgoing
02 168
Tarih/Dt. 09-09-2025

02 Nr. 168 /25
Me 09.09./2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr-28/2008, neni 25 paragrafi 5 Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrtarët publik, lidhur me neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Rregullores (QRK) NR. 28/2024 Për Pezullimin Nga Marrëdhënia e Punës, si dhe në bazë të neni 45, 46 47 dhe 48 Ligjit Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative Statutit te Komunës se Mamushes 001/2008 e datës 01.12.2008.

## V E N D I M
**për ndryshimin në listë të pagave për pezullimin e përkohshëm nga vendi i punës**

**Neni 1**

Nëpunësi Publik, z. **Fikret Morina**, me numër personal [redacted],, i sistemuar në vendin e punës sipas kontratës Mësimdhënës në Sh.F.M.U. "ANADOLU", pezullohet përkohësisht nga ushtrimi i detyrës pa kompensim financiar, duke filluar nga data 06.09.2025 (shtatë [7] ditë para hapjes zyrtare të fushatës për zgjedhjet lokale), deri më datën 17.10.2025 (pesë [5] ditë pas përfundimit të saj), në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi që rregullojnë statusin e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor.

**Neni 2**

**Obligohet**: Drejtoria e Arsimit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin ta përcjellë dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listën e pagave, në bazë të vendimit për pezullimin përkohshëm nga vendi i punës. Të lartpërmendurit nuk i takon kompensimi për gjatë periudhës së cekur në nenin 1 të këtij vendimi.

**Neni 3**

Ky vendim hyn në fuqi nga data e përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi

## A R S Y E T I M

Në bazë të kërkesës së Nëpunësit Publik, z. Fikret Morina, me numër personal **1070008803**, lidhur me kandidimin e tij në zgjedhjet lokale 2025, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi që rregullojnë statusin dhe sjelljen e nëpunësve gjatë procesit zgjedhor, përcaktohet si më poshtë:

Çdo nëpunës publik që kandidon në zgjedhje nacionale apo lokale është i obliguar të pezullojë përkohësisht ushtrimin e funksionit të tij nëpunës pa kompensim financiar,

duke filluar shtatë (7) ditë para hapjes zyrtare të fushatës zgjedhore dhe deri pesë (5) ditë pas përfundimit të saj.

Kjo masë ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe paanshmërinë e procesit zgjedhor, si dhe të eliminojë çdo konflikt të mundshëm interesi ndërmjet funksionit zyrtar dhe angazhimit politik. Gjithashtu, parandalon çdo mundësi të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, resurseve institucionale apo autoritetit publik për përfitime politike apo elektorale.

Me këtë vendim për pezullimin e përkohshëm nga puna, institucioni garanton zbatimin e ligjit, ruajtjen e profesionalizmit dhe besimit të publikut në institucionet publike, duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë kandidatët që marrin pjesë në zgjedhje.

Ky vendim mbështetet në frymën e legjislacionit për administratën publike, standardet demokratike dhe praktikat e mira të qeverisjes, duke reflektuar angazhimin e institucionit për respektimin e rendit kushtetues dhe të drejtës për pjesëmarrje politike, pa cenuar paanshmërinë e shërbimit civil.

**Kryetari i Komunës së Mamushës**

**Abdülhadi Krasniç**

Me këtë njoftohen

DKA
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 167-25
Tarih 09.09.2025

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

02 Nr. 167-25
Tarih : 09.09.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr-28/2008, neni 25 paragrafi 5 Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrtarët publik, lidhur me neni 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Rregullores (QRK) NR. 28/2024 Për Pezullimin Nga Marrëdhënia e Punës, si dhe në bazë të neni 45, 46 47 dhe 48 Ligjit Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative Statutit te Komunës se Mamushes 001/2008 e datës 01.12.2008.

## VENDIM
## *PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM NGA VENDI I PUNËS*

**Neni 1**

Nëpunësit Publik, Fikret Morina me numër personal [redacted], , i sistemuar në vendin e punës sipas kontratës Mësimdhënës në Sh.F.M.U ANADOLU i pezullohet përkohësisht vendi i punës **pa pagesë**, duke filluar nga data 06.09.2025, që është shtatë (7) ditë para hapjes zyrtare të fushatës për zgjedhjet Lokale, deri më datën 17.10.2025, pesë (5) ditë pas mbylljes së saj.

**Neni 2**

Gjatë periudhës së pezullimit, të punësuarit nuk i takon paga dhe benefite të tjera që rrjedhin nga kontrata e punës, përveç kthimit të tij në vendin e punës pas mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi.

**Neni 3**

**Obligohet:** Drejtoria e Arsimit në Komunën e Mamushës që të ndërmarrë procedurat e nevojshme për pezullimin nga puna dhe ndaljes së pagës për periudhën e cekur në nenin 1 të këtij vendimi.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe i dërgohet personit të interesuar, si dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore për zbatim.

## ARSYETIM

Nëpunësit Publik, Fikret Morina me numër personal [redacted], pas kandidimit të tij në zgjedhjet **lokale 2025**. Bazuar në rregulloret dhe dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë statusin e nëpunësve civilë dhe sjelljen e tyre gjatë periudhës zgjedhore, parashihet qartë se çdo zyrtar publik që kandidon në zgjedhje nacionale apo lokale, është i obliguar të pezullojë përkohësisht ushtrimin e funksionit të tij nëpunës, pa kompensim financiar, duke filluar shtatë (7) ditë para hapjes zyrtare të fushatës zgjedhore dhe deri pesë (5) ditë pas përfundimit të saj.

Kjo masë ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe paanshmërinë, si dhe të eliminojë çdo konflikt të mundshëm interesi mes funksionit zyrtar dhe angazhimit politik të nëpunësve

gjatë fushatës zgjedhore. Po ashtu, parandalon çdo mundësi të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, resurseve institucionale apo autoritetit publik për përfitime politike apo elektorale.

Me këtë vendim të pezullimit përkohësisht nga puna, institucioni garanton zbatimin e ligjit, ruajtjen e profesionalizmit dhe besimit të publikut në institucionet publike, si dhe krijon kushte të barabarta për të gjithë kandidatët që marrin pjesë në zgjedhje.

Për më tepër, ky vendim mbështetet në frymën e legjislacionit për administratën publike, standardet demokratike dhe praktikat e mira të qeverisjes, duke reflektuar angazhimin e institucionit për respektimin e rendit kushtetues dhe të drejtës për pjesëmarrje politike, pa cenuar paanshmërinë e shërbimit Publik.

Me këtë njoftohet

- **NJMBNJ**
- **Palës**
- **DKA**
- **Arkiva**

Kryetari i Komunës

Abdülhadi Kraniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No,Nr. 02 167-25
Tarih/Dt. 09.09.2025

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

02 Nr. 167-25
Tarih : 09.09.2025

03/L-040 sayılı ve Kosova Cumhuriyeti Resmî Gazetesi'nin 28/2008 sayılı nüshasında yayımlanan Yerel Yönetim Kanunu'nun 13 ve 58'inci maddelerine, 08/L-197 sayılı Kamu Görevlileri Kanunu'nun 25'inci maddesinin 5'inci fıkrasına, İş İlişkisinden Uzaklaştırma Hakkında (QRK) 28/2024 sayılı Yönetmeliğin 5'inci maddesinin 1'inci fıkrasının 1.8 bendine, 05/L-031 sayılı Genel İdari Usul Kanunu'nun 45, 46, 47 ve 48'inci maddelerine ve 01.12.2008 tarihli Mamusa Belediyesi Tüzüğü'nün 001/2008 sayılı hükümlerine dayanarak

**K A R A R**
**GEÇİCİ OLARAK GÖREVDEN UZAKLAŞTIRMA KARARI**

**Madde 1**

Anadolu İlköğretim Okulu'nda sözleşmeye göre öğretmen olarak görev yapan [redacted] kişisel numarasşna sahip Kamu Görevlisi Fikret Morina, yerel seçimler için resmi seçim kampanyasının açılış tarihinden yedi (7) gün önce olan 06.09.2025 tarihinden başlayarak, kapanış tarihinden beş (5) gün sonrasına denk gelen 17.10.2025 tarihine kadar, maaşsız olarak görevinden geçici süreyle uzaklaştırılır.

**Madde 2**

Görevden uzaklaştırma süresi boyunca çalışana, maaş ve iş sözleşmesinden kaynaklanan diğer hak ve menfaatler ödenmeyecektir. Ancak, bu kararın 1. maddesinde belirtilen sürenin sona ermesiyle birlikte tekrar görevine geri dönme hakkına sahiptir.

**Madde 3**

Bu karar imzalandığı tarihte yürürlüğe girer ve ilgili personele iletilir. Ayrıca İnsan Kaynakları Birimi'ne uygulama için gönderilir.

**GEREKÇE**

Kamu Görevlisi Fikret Morina, kişisel numarası [redacted], 2025 yerel seçimlerine aday olmasının ardından; yürürlükte olan kamu görevlilerinin statüsünü ve seçim dönemi davranışlarını düzenleyen yönetmelik ve yasal hükümlere dayanarak, ulusal veya yerel seçimlere aday olan her kamu görevlisinin, resmi seçim kampanyasının açılış tarihinden yedi (7) gün önce başlayarak ve kampanyanın bitiminden beş (5) gün sonrasına kadar, mali tazminat almadan görevini geçici olarak durdurması zorunlu olduğu açıkça öngörülmektedir.

Bu önlem, bütünlük ve tarafsızlığın sağlanması, ayrıca seçim kampanyası süresince resmi görev ile siyasi katılım arasında oluşabilecek herhangi bir çıkar çatışmasının önlenmesi

amacını taşımaktadır. Aynı zamanda, resmi konumun, kurumsal kaynakların veya kamu otoritesinin siyasi veya seçimsel çıkarlar için kötüye kullanılma ihtimalini ortadan kaldırır.

Bu geçici görevden uzaklaştırma kararıyla, kurum yasaların uygulanmasını, profesyonellik ve kamuoyunun kamu kurumlarına duyduğu güveni korumayı, ayrıca seçimlere katılan tüm adaylar için eşit şartların oluşturulmasını garanti eder.

Ayrıca, bu karar kamu yönetimi mevzuatının ruhuna, demokratik standartlara ve iyi yönetişim uygulamalarına dayanmaktadır; kurumun anayasal düzenin korunması ve siyasi katılım hakkına saygı gösterme taahhüdünü yansıtırken, kamu hizmetinin tarafsızlığının zedelenmesini engeller.

Belediye Başkanı

Abdulhadi Krasniç

Dağıtım:
- İnsan Kaynakları Birimi
-Şahıs
-*BEM*
-Arşiv

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 166-25
08.09.2025

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

02 Nr.166/25
Me 08.09.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/l-212 i Punës lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë 01/2008 të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për hyrje në listë të pagave**

**Neni 1**

z. Endrit Hoti me numër personal: [redacted], i cili sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Mamushës me titull të Mjek i Përgjithshëm në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare me numër të referencës: **RN00018143** është përzgjedhur si fitues i konkursit në fjalë dhe me datën 01.09.2025 ka nënshkruar Kontratën e punës me numër të protokollit 02-156/25 e datës 08.09.2025 me titull të pozitës Mjek i Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, Grada /Koeficienti për pozitën Mjekë i Përgjithshëm, H10-8.40.

**Neni 2**

**Obligohet-** Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të hyrjes në listë të pagave në bazë të Kontratës së punës me numër të protokollit 02-156/25 e datës 08.09.2025.

**Neni 3**
Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

z. Endrit Hoti me numër personal: [redacted], ka aplikuar në konkursin publik për pozitën **"Mjek i Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë"**, të shpallur nga organi kompetent. Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit dhe vlerësimit, ai është shpallur fitues i këtij konkursi.

Në përputhje me këtë, me datën 08.09.2025, ka nënshkruar **Kontratën e Punës**, me numër protokolli 02-156/25 e datës 08.09.2025, për ushtrimin e detyrave në pozitën Mjek i Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë.

Duke u bazuar në **Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik**, dhe duke marrë parasysh se z. Endrit Hoti e ka filluar zyrtarisht marrëdhënien e punës, ai duhet të përfshihet në **listën e pagave**, sipas pozitës së caktuar dhe koeficientit përkatës.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria e Shëndetësisë
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

**Kryetari i Komunës së Mamushës**

**Abdülhadi Krasniç**

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 165/25
08.09.2025

02 Nr. 165 /25
Me 08.09.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenit 76 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.4 dhe neni 8 i Rregullores (QRK) nr.29/2024 Për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, Statutit të Komunës së Mamushës 001/2008 e datës 01.12.2008.

**V E N D I M**
**Për largimin nga lista e pagave**

**Neni 1**

Znj. Besire Gjini, e lindur më datë 09.09.1960, me nr. personal [redacted], e sistemuar në vendin e punës Udhëheqëse e Tatimit në Pronë në Komunën e Mamushës, me vendim numër të protokollit 02-Nr.162/25 e datës 08.09.2025 iu është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 09.09.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2**

Obligohet Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës që për të lartcëcekurën ta përcjellë dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), me qëllim të largimit nga lista e pagave në bazë të vendimit me numër të protokollit 02-Nr.162/25 e datës 08.09.2025.

**Neni 3**

Ky vendim hyn në fuqi nga data 09.09.2025.

**A R S Y E T I M**

Znj. Besire Gjini, e lindur më datë 09.09.1960, me nr. personal [redacted], të cilës me datën 09.09.2025 iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Largimi nga lista e pagave bëhet për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës sipas fuqisë ligjore, kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

Për realizimin e kësaj procedure, Zyra e Personelit duhet të përcjellë dokumentacionin e nevojshëm tek Thesari i Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe

Transfereve (MFPT), me qëllim të ekzekutimit korrekt dhe ligjor të kompensimit sipas dispozitave në fuqi.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

**Kryetari i Komunës së Mamushës**

**Abdülhadi Krasniç**

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 164-25
Tarih/Dt. 08.09.2025

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

**02 Nr. 164-25**
**Datë 08.09.2025**
**Mamushë**

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 21 Ligji nr. 08/l-197 për Zyrtarët Publik, nenit 9 paragrafi 9 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik lidhur me nenin 32 paragrafi 9 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, neni 44, 45, 46 të Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative statutit te Komunës së Mamushë, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**PËR KOMPENSIMIN E DITËVE TË PASHFRYTËZUARA TË PUSHIMIT VJETOR**

**Neni 1**

Nëpunëses znj. Besire Gjini, e lindur më datë 09.09.1960, me nr. personal [redacted], do t'i bëhet kompensimi financiar për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor për vitin 2025, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

**Neni 2**

Numri i ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor për vitin 2025 është 13 ditë pune. Kompensimi financiar për këto ditë do të llogaritet në bazë të pagës bazë mujore të nëpunëses, të ndarë proporcionalisht sipas numrit të ditëve të punës, në shumën prej 448.27 euro.

**Neni 3**

Kompensimi financiar i ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor realizohet në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe trajtimin e të drejtave të punonjësve në këto raste.

**Neni 4**

Obligohet Zyra e Personelit që për personin e lartcekur të përcjellë dokumentacionin përkatës tek Thesari i Kosovës, pranë Ministrisë së Financave (MFPT), me qëllim të pagesës së ditëve të pashfrytëzuara të pushimit.

## Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Nga verifikimi i kryer nga Zyra e Personelit është konstatuar se nëpunësja Besire Gjini nuk ka arritur t'i shfrytëzojë ditët e saj të pushimit vjetor për vitin 2025, pavarësisht të drejtës ligjore për pushim, për shkak të ngarkesës së lartë në punë dhe detyrave të domosdoshme që ka pasur gjatë periudhës së caktuar.

Dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi përcaktojnë qartë se ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor mund të kompensohen me pagesë, në rastet kur marrëdhënia e punës ndërpritet. Në këtë rast, marrëdhënia e punës me nëpunësen në fjalë ndërpritet më datë 09.09.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, çka përbën bazë të plotë ligjore për zbatimin e përjashtimit të paraparë në nenin 9, paragrafi 9 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, si dhe në nenin 32, paragrafi 9 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Në këto rrethana, dhe me qëllim të respektimit të drejtave të punonjësve sipas legjislacionit në fuqi, është e domosdoshme që nëpunëses t'i bëhet kompensimi financiar për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor, të cilat nuk ka pasur mundësi t'i shfrytëzojë për shkaqe objektive, të lidhura me interesin e shërbimit.

- NJMBNJ
- Drejtoria Për Buxhet dhe Financa
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdulhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

